



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 69 regjistër (JR)
Datë 11.11.2021

Nr. 32 i vendimit
Datë 03.07.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 03.07.2024, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, i Kushtetutës, neni D i Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; nenet 6, 7, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, që përfundimisht kërkoi konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. Pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {***} prot., datë 25.10.2018, sipas së cilit:

1. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
5. *Subjekti nuk gjendet situatën e konfliktit të interesave.*

4. Me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera. Për këtë

qëllim ka dërguar raportin e hartuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

5. Për vlerësimin e aftësive profesionale, KLGj-ja, pasi ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tri kriteret e vlerësimit, të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Bazuar në provat e administruara, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin që subjektit të rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 437, datë 10.09.2021, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
7. Në vendim, Komisioni ka konkluduar për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit mbi konkluzionet si më poshtë.

7.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: “(i) Trupi gjykues çmon se për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të paplotë dhe të pasaktë të pasurive të saj në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, duke u përprjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë shpenzimet për vajzën (personi i lidhur) në vitin 2016 në ShBA dhe mënyrën e përballimit të tyre, dhe për shkak se rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në përputhje me pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. (ii) Trupi gjykues vlerëson se veprimet e kryera nga kjo gjyqtare për të përfutur një pasuri në statusin “e pastrehë” (prej saj dhe personit të lidhur), pasuri të cilën e ka përdorur më tej duke gjeneruar të ardhura, duket e papranueshme duke e klasifikuar këtë sjellje sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në cenim të besimit të publikut të drejtësia. (iii) Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së saj në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe ndaj saj duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra”.

7.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: “Trupi gjykues vlerëson se nga rrethanat e konstatuara nga Grupi i Punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton se subjekti Kaçe Agolli ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se nuk u provua gjatë hetimit që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikave 2 dhe 3, të nenit 61, të

ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës”.

7.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: “Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ndonëse nuk konsiderohet si i paaftë dhe i papërshtatshëm, sipas analizës mbi vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga germa “c”, e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, çmon se problematika e konstatuar në vendimmarrjen e dhënë nga trupi gjykues në vendimin nr. {***} (pjesë e të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit), ngrenë pikëpyetje serioze për mënyrën se si subjekti ka performuar në raport me të drejtën dhe legjislacionin e zbatueshëm, e vlerësuar kjo edhe në raport me eksperiencën e gjatë në detyrë dhe aftësitë profesionale të subjektit. Trupi gjykues vlerëson se duke konsideruar edhe problematikën e konstatuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk mund të jetë i aplikueshëm rekomandimi për ndjekjen e programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, por shihet i arsyeshëm një vlerësim i kësaj rrethane në këndvështrim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.

II. Mbi ankimin dhe shkaqet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

8. Më datë 25.10.2021, subjekti i rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli, paraqiti pranë Komisionit ankimin, i cili u protokollua me nr. {***} prot., kundër vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky ankim është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63¹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi prova bashkëlidhur ankimit. Në përfundim të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar prishjen e vendimit të Komisionit, në përputhje me nenin 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, si vendim i marrë në shkëlqje të procedurës, parimeve kushtetuese të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

8.1. Shkaqet procedurale të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

8.1.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është marrë si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, pasi vjen në kundërshtim të hapur me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

8.1.2. *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 93 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk mund të cenohet besimi i publikut kur ajo dhe bashkëshorti i saj kanë marrë autorizim për strehim, si dhe kredia e marrë për shlyerjen e këtij apartamenti ishte në vazhdim të kryerjes së pagesave. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se përfundimi i Komisionit se subjekti gjendet në pamundësi financiare për të ndërtuar shtesën e apartamentit në rrugën “{***}”, për shumën 1.849.718 lekë, është i gabuar, pasi kjo pamundësi

¹ “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”.

lidhet me mosmarrjen si të ligjshme të të ardhurave nga qiraja, edhe pse ka sjellë të gjithë mandatpagesat e qirasë së dhënë nga shoqëria “{***}” ShPK.

Në lidhje me shtesën e apartamentit në rrugën “{***}”, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit është alogjik, kur arsyeton se kjo shtesë nuk është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshortit i saj, por nga nëna e subjektit, të cilën nuk e lidhte asgjë me këtë pasuri, gjë që krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka dashur ta shmangë këtë deklaram.

Subjekti pretendon se ka përmbushur detyrimin për deklaram, por edhe sikur të ishte e kundërta, sipas saj, procesi i *vetting*-ut nuk ka për qëllim të hetojë pasuritë e trashëguara nga të tjerë sipas ligjit.

8.1.3. Lidhur me ndërtimin e shtesës anësore të apartamentit, me nr. pasurie {***}, ndodhur në rrugën “{***}”, që është ndërtuar në objektin ekzistues apartament banimi, me të cilin është trajtuar me strehim nëpërmjet EKB-së subjekti dhe bashkëshorti i saj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është alogjik. Në këtë objekt banimi secili prej banorëve të pallatit ka investuar për ndërtimin e një shtese banimi në apartamentet respektive. Burimi i krijimit, sipas deklaratës *vetting*, janë të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit në rrugën “{***}”, në shumën 600 USD/muaj dhe kursimet familjare. Pjesa takuese: 100% në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

8.1.4. Lidhur me shpenzimin prej 500.000 lekësh, të marrë kredi në datën 14.01.2016, në Credins Bank, për vajzën e saj, për të mbuluar shpenzimet e jetesës në ShBA, në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se ky është shpenzimi i vetëm i kryer në këtë vit për vajzën. Subjekti pretendon se me paraqitjen e një deklaratë të shtetasës amerikane, znj. R. Q., ka provuar se vajza e saj, S. A., ka qëndruar me deklaruosen në dhomën që kishte tepër të apartamentit të saj që nga viti 2016 e në vijim. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer interpretim të gabuar, duke qenë se në logjikë të thjeshtë miku nuk paguan për ndenjen. Subjekti kërkon që të intervistohet znj. R. Q. nga ana e Kolegjit në mënyrë të tillë që të vërtetohen pretendimet e saj.

Subjekti pretendon se nuk është e drejtë përlllogaritja e Komisionit për qiranë e një dhome, në vlerën 1.600 USD në muaj, ndërkohë që vajza e saj paguhet 600 USD në javë. Sipas subjektit të rivlerësimit, standardi i ndjekur për vajzën e subjektit është i kundërligjshëm dhe dashakeq. Subjekti ka sqaruar në ankim se marrëdhënia e vajzës së saj me znj. R. Q. është marrëdhënie huapërdorje dhe rregullohet nga nenet 901-912 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

8.1.5. Lidhur me të dhënat në formë indicie konfidenciale, për të cilat Komisioni është vënë në dijeni, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se nuk i është vënë në dispozicion asnjë relacion i relatorit apo i vëzhguesit ndërkombëtar, për llojin e informacionit të marrë dhe burimin. Subjekti i rivlerësimit sqaron në ankim se nuk është thënë që vendimi i gjykatës shqiptare do të ekzekutohet vetëm nëse Gjykata e Apelit Amsterdam do ta gjejë me vend apo jo, dhe as është thënë se vendi i ekzekutimit është Holanda. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit pretendon se Gjykata e Apelit Amsterdam ka gjykuar korrektësinë, themelin e çështjes dhe ka zëvendësuar logjikën e gjykatës. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit për këtë çështje nuk është i ligjshëm e as logjik.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit, znj. Kaçe Agolli, duke vendosur shkarkimin e saj nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit kryhet në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, gjithashtu dhe në rastet kur nuk jemi në kushtet e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” [në vijim “ligji nr. 49/2012”]. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në bazë të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova të reja me dorëzimin e ankimit, si dhe nuk ka paraqitur parashtrime e prova me qëllim administrimin e tyre në Kolegj. Trupi gjykues vlerësoi që çështja e subjektit të rivlerësimit të gjykohet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazën e akteve të administruara në Komision, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

² “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli

Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është marrë si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, pasi vjen në kundërshtim të hapur me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit, sa i përket vendimit të Komisionit, ngre pretendime për shkeljet si vijon:
- është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor;
 - është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë në procedim disiplinor, duke paragjykuar haptazi çështjen;
 - është cenuar parimi i sigurisë juridike, parimi i barazisë para ligjit, parimi i barazisë së armëve;
 - janë vlerësuar provat në mënyrë të gabuar dhe haptazi në mënyrë të njëanshme;
 - nuk është respektuar parimi i objektivitetit.

12.1. Në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të Komisionit, subjekti pretendon se nuk paraqiten saktë provat mbi të cilat është krijuar bindja e Komisionit për këtë vendimmarrje, pasi nuk ka analizë financiare, si dhe janë njohur të ardhurat e bashkëshortit, por pa shpjeguar si janë njohur.

Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën³ e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e cila thekson domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Ajo arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve, në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në referencë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për të ardhurat që Komisioni i ka njohur për bashkëshortin, duke pretenduar se në vendim nuk rezultojnë të jetë cituar vlera monetare e konsideruar nga Komisioni, Kolegji vëren se vlera nuk është cituar as në dokumentacionin⁴ që subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision, për të provuar të ardhurat e përfituara të bashkëshortit si punonjës i Gardës së Republikës. Komisioni me rezultatet e hetimit i ka përlllogaritur të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, por pa dhënë shpjegime se në cilat dokumente e ka bazuar përlllogaritjen, pavarësisht se e ka njohur me metodologjinë e analizës financiare. Pasi subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, edhe pse nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor se në çfarë vlere duhet të

³ *Shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015, nr. 63, datë 23.09.2015, nr. 24, datë 25.04.2016 dhe nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.*

⁴ *Shkresë nr. {***} prot., datë 12.08.2021, e Gardës së Republikës.*

konvertoheshin nga Komisioni shpenzimet e mbuluara për shkak të detyrës së bashkëshortit të saj, Komisioni duket se në një qëndrim garantist ka zbritur nga shpenzimet jetike të familjes, shpenzimet e bashkëshortit, duke zbritur në këtë mënyrë diferencën negative në një vlerë më të madhe se shpenzimi për një anëtar familje, sipas standardit të ILDKPKI-së për vitet 1999-2001. Në vijim të rishikimit të analizës rezultoi se Komisioni zbriti diferencën negative nga (-) 2.818.910 lekë në rezultatet e hetimit në (-) 1.849.718 lekë, pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për këto rezultate. Subjekti i rivlerësimit në ankim nuk paraqiti pretendim për ndonjë provë konkrete që Komisioni të mos ia ketë shqyrtuar. Kolegji nuk konstatoi pasaktësi në lidhje me ndonjë provë të referuar në vendimin e Komisionit. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në Kolegj ndaj analizës financiare të Komisionit, konfirmohet diferenca negative e rezultuar në Komision para vitit 2001. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi është arsyetuar në përputhje me standardet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese dhe, si rrjedhojë, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi është i paarsyetuar, për pasojë nuk evidentoi shkelje të procesit të rregullt ligjor.

12.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë si pjesë e elementëve të procesit të rregullt ligjor, subjekti nuk ka parashtruar argumente për këtë shkelje të pretenduar se është kryer nga Komisioni. Sipas nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal. Me kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ, Komisioni nuk ka cenuar të drejtën e subjektit për t'u mbrojtur, por përkundrazi ka zbatuar procedurën e rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit kushtetues dhe atij ligjor.

12.3. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se vendosja e barrës së provës për mundësinë ekonomike të subjektit dhe bashkëshortit për të përballuar shpenzimet e vajzës jashtë shtetit, që s'janë bërë kurrë, nuk është respektim i këtij parimi, duke pretenduar se subjekti është vendosur në situatë të pafavorshme ligjore. Subjekti pretendoi se kjo siguri që jep ligji, si dhe provat shpresore nuk janë marrë parasysh nga Komisioni.

Lidhur me këto pretendime të subjektit, Kolegji sjell në vëmendje se siguria juridike është ndër elementët thelbësorë të shtetit të së drejtës, e cila presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e vazhdueshme të ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore.

Duke vlerësuar në tërësi rrethanat, të cilat i referohen analizës së shkakut të ankimit, duke pasur parasysh procesin e vlerësimit të pasurive personale ose familjare të krijuara gjatë jetës profesionale të subjektit të rivlerësimit, kjo e fundit dështoi për të paraqitur dokumente mbështetëse që vërtetojnë qëndrimin pa shpenzime të vajzës së saj në vitin 2016 në ShBA, si

rrjedhë, duke mos konstatuar shkelje të parimit të sigurisë juridike, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

12.4. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nga Komisioni janë vlerësuar provat në mënyrë të njëanshme dhe se nuk është respektuar parimi i objektivitetit, subjekti nuk ka paraqitur argumente për këto shkelje dhe pasojën që kanë sjellë për të. Kolegji vëren se nga verifikimi i procedurave të zhvilluara në Komision konstatohet se subjektit të rivlerësimit i janë respektuar të drejtat për një proces të rregullt dhe ligjor. Konkretisht, rezulton se subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta e njohjes me aktet e administruara gjatë hetimit paraprak, që çështja e saj të dëgjohet drejtësisht, publikisht, si dhe brenda një afati të arsyeshëm. Vendimi i është komunikuar, duke i dhënë më parë të drejtën për të paraqitur mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore, si dhe të depozitohet prova. Komisioni me të drejtë i ka marrë në konsideratë provat dhe i ka vlerësuar sipas bindjes së krijuar për vlerën e tyre provuese. Si rrjedhojë e sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në Komision janë vlerësuar provat në mënyrë të njëanshme dhe se nuk është respektuar parimi i objektivitetit nuk gjendet i bazuar.

12.5. Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, rezulton se procesi i rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së, i është garantuar subjektit të rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli. Neni 42, pika 2 e Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*. Kjo dispozitë kushtetuese nuk rezulton të jetë shkelur nga Komisioni në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për cenim të procesit të rregullt ligjor nga Komisioni, nuk gjendet i bazuar.

- 13.** *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 93 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk mund të cenohet besimi i publikut kur ajo dhe bashkëshorti i saj kanë marrë autorizim për strehim, si dhe kredia e marrë për shlyerjen e këtij apartamenti ishte në vazhdim të kryerjes së pagesave. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se qëllim i blerjes së këtij apartamenti ka qenë për ta kthyer në biznes, duke qenë se në vitin 1997, kur është përfutur apartamenti, nuk ishin kushtet sociale për të menduar për biznes. Gjithashtu, subjekti pretendon se dhënia me qira nuk është veprimtari tregtare, pasi s’mund të quhet marrëdhënie tregtare një kontratë civile që nuk konsiderohej e tillë sipas ligjit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se përfundimi i Komisionit se subjekti gjendet në pamundësi financiare për të ndërtuar shtesën e apartamentit në rrugën “{***}”, për shumën 1.849.718 lekë, është i gabuar, pasi kjo pamundësi lidhet me mosmarrjen si të ligjshme të të ardhurave nga qiraja edhe pse subjekti ka sjellë të gjithë mandatpagesat e qirasë së dhënë nga shoqëria “{***}” ShPK. Subjekti pretendon se i ka deklaruar në deklaratat periodike këto të ardhura dhe nuk është bërë me dije asnjëherë se për to duhet të paguhej tatim.

Në lidhje me shtesën e apartamentit në rrugën “{***}”, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit është alogjik, kur arsyeton se mosdeklarimi i kësaj shtese nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, por nga nëna e subjektit, të cilën nuk e lidhte asgjë me këtë pasuri, krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka dashur ta shmangë këtë deklaram.

Në lidhje me mosregjistrimin e apartamentit të trashëguar nga prindërit, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk është dakord me konkluzionin e Komisionit se tërësia e veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, regjistrimi i saj, si dhe vlerësuar në raport me pasurinë apartament + garazh, në rrugën “{***}”, e vendosin atë në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky fakt jo vetëm që është në kundërshtim me ligjin, por edhe në kundërshtim me një logjikë normale. Subjekti pretendon se ka përmbushur detyrimin për deklaram, por edhe sikur të ishte e kundërta, sipas saj, procesi i *vetting*-ut nuk ka për qëllim të hetojë pasuritë e trashëguara nga të tjerë sipas ligjit.

13.1. Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *“Në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, rezulton se në vitin e pajisjes me autorizim strehimi nga Bashkia Tiranë, subjekti dhe bashkëshorti, në përmbushje të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit në familjet e pastreha”, nuk figuronin me pasuri në pronësi, por Komisioni krijon bindjen se veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, të cilët kanë hequr dorë nga një pasuri tjetër ku ishin bashkëpronarë, janë kryer me qëllim përfitimin e statusit “të pastrehë”. Kjo edhe për faktin se nga hetimi rezulton se kjo pasuri është dhënë me qira që në momentin fillestar kur është marrë në përdorim dhe nuk është shfrytëzuar nga subjekti për strehim. Përfitimi nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti në vitin 1993 të bashkëpronësisë në një pasuri tjetër (atë të prindërve të subjektit të rivlerësimit) duket legjitime dhe në raport të drejtë me kërkesat e kohës (legjislacionin në fuqi në raport me sipërfaqen, numrin e bashkëpronarëve dhe situatën reale të banimit). Përpyekjet e tyre për të hequr dorë nga një pasuri ku ishin bashkëpronarë si dhe mosregjistrimi i asaj pasurie ende në emër të subjektit të rivlerësimit krijojnë bindjen se janë veprime të qëllimshme të kryera pikërisht për legjitimin e tyre në vitin 1997 për të përfutuar edhe një pasuri tjetër publike. Kjo situatë, në vlerësim të trupit gjykues, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.*

13.2. Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament 3+1 ndërtuar pas vitit 1990, me sip. 93 m², me vleftë 2.1 milion lekë”* dhe me burim krijimi: *“Me kredi nga Enti i Banesave”.*

Në Deklaratën e Interesave Periodike Pasurore (në vijim “DIPP”), të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi apartamentin e sipërcituar, si edhe një garazh, për të cilin ka paguar shumën 300.000 lekë.

13.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament me sipërfaqe banimi respektivisht 93 m² dhe garazh me sip. 28 m², me adresë në rrugën “{***}”, marrë me kredi nga Enti Kombëtar i Banesave me afat shlyerje 25 vjet, interes 0% dhe këste mujore prej 5.800 lekësh, me vlerë apartamenti 2.260.624 lekë, me pagesë fillestare 40.000 lekë, si dhe pagesë prej 900.000 lekësh (nga të cilat 340.000 lekë janë paguar për blerjen e*

garazhit). Për apartamentin nga momenti i lidhjes së kontratës me EKB-në është likuiduar në total me këste vlera 1.239.580 lekë, dhe vlera e kredisë për t'u paguar në vazhdim është 421.814 lekë. Kontrata e shitjes me kusht nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 26.11.1999, bashkëngjitur vërtetimit nr. {***} prot., datë 27.10.2016, bashkëngjitur mandati i lëshuar nga Enti Kombëtar i Banesave Tiranë”.

13.4. Komisioni i ka kërkuar Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”) informacion për dokumentacionin e kësaj pasurie, i cili me shkresën kthim përgjigje⁵ ka dërguar dosjen e plotë të privatizimit të apartamentit dhe garazhit në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Sipas këtij dokumentacioni rezultojnë se:

i) Më datë 25.04.1997 është lidhur kontrata e përkohshme (jo para noterit), ndërmjet Degës Rajonale të EKB-së Tiranë dhe bashkëshortit të subjektit, kontratë e cila shërbente si garanci për shitjen e apartamentit të banimit me strukturë 3+1 dhe garazhin në pallatin që ishte në ndërtim e sipër. Sipas nenit 5 të kësaj kontrate, blerësit i ngarkohej paraprakisht kryerja e pagesës në vlerën 40.000 lekë si paradhënie për banesën në ndërtim. Kjo vlerë i është paguar EKB-së nga bashkëshorti i subjektit, sipas mandatarkëtimit të bashkëlidhur këtij dokumentacioni, me nr. {***}, datë 25.04.1997, me përshkrimin *kontratë provizore*.

ii) Më datë 28.02.1998 është lidhur kontrata nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., për shitjen e garazhit me sipërfaqe 28,39 m², me vlerë 328.862 lekë, së bashku me taksën e EKB-së për pagesën e shpenzimeve operacionale prej 4% në shumën 11.908 lekë, të cilat përbëjnë në total shumën **340.770** lekë, të paguara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit jashtë zyrës noteriale, me mandatarkëtimin nr. {***}, datë 19.08.1997, për llogari të EKB-së. Sipas kësaj kontrate, shitësi i dorëzon blerësit garazhin më datë 28.02.1998, duke u zhveshur nga e drejta e pronësisë.

iii) Më datë 26.11.1999 është nënshkruar kontrata e shitjes me kusht nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., ndërmjet subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj dhe Degës Rajonale të EKB-së Tiranë, për apartamentin e banimit me vlerë 2.260.624 lekë, i cili do të shlyhej me interes 0%, me këst mujor 5.800 lekë. Në këtë kontratë është parashikuar se në zbatim të VKM-së nr. 291, datë 21.06.1994, “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 4, datë 22.08.1994, përfiton kredi me afat shlyerje për 25 vjet.

13.5. Referuar kontratës së shitjes me kusht për këtë apartament specifikohet se blerësi ka paguar në vitin 1997 (sipas mandatarkëtimeve për muajt prill/gusht) shumën prej 639.230 lekësh, e cila përfshin: (a) vlerën 553.752 lekë si pagesë fillestare të kontratës provizore; dhe (b) vlerën 85.478 lekë si shpenzime operacionale në ngarkim të EKB-së. Gjithashtu, në këtë kontratë përcaktohet edhe vlera e paguar në mënyrë të menjëhershme për garazhin në vlerën 340.770 lekë (cituat në paragrafin më sipër).

13.6. Për këto dy pagesa të kryera në vitin 1997, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe as në DIPP-të e viteve 2003-2004 burimin e të ardhurave që ka përdorur

⁵ Shkresë nr. {***} prot., datë 15.05.2021, e Entit Kombëtar të Banesave.

për kryerjen e tyre. Për këtë arsye, Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e pagesës në vlerën totale prej 980.000 lekësh paguar në vitin 1997, në të cilën përfshihen përkatësisht, vlerat 639.230 lekë për apartamentin dhe 340.770 lekë për garazhin. Nga kjo analizë Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të përballuar në vitin 1997 vlerën totale prej 980.000 lekësh, për kryerjen e pagesave për blerjen e apartamentit dhe garazhit, për një diferencë negative në shumën (-) **271.427 lekë**. Bashkë me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, lidhur me mosjustifikimin e shumës prej 271.427 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacion duke kërkuar rilogaritje të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i saj. Komisioni ka marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për përfitimin e trajtimit ushqimor dhe uniformën civile nga statusi i oficerit të bashkëshortit, dokumentacion i cili nuk qartësonte shpenzimet e mbuluara për shkak të detyrës së tij. Komisioni nuk llogariti shpenzime jetike për bashkëshortin për periudhën kohore 1995-2006, por pa sqaruar metodologjinë e zbritjes së këtyre shpenzimeve, i zbriti ato duke ulur diferencën negative në një vlerë më të madhe se standardi i ILDKPKI-së për një anëtar familjeje për vitet 1999-2001. Në vijim të rishikimit të analizës financiare, Komisionit i rezultoi se deri në muajin gusht të vitit 1997 subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të investuar në vlerën 980.000 lekë për pagesat e apartamentit dhe garazhit.

13.7. Subjektit të rivlerësimit iu kërkuar nga Komisioni të shpjegojë lidhur me statusin e pasurisë garazh dhe shkaqet e mosregjistrimit të kësaj pasurie në emër të subjektit dhe bashkëshortit. Subjekti i rivlerësimit në prapësime ka shpjeguar se: *“Për garazhin sqaroi se nuk ka qenë mungesa e dëshirës për ta regjistruar, por na është thënë që nëse nuk regjistrohet apartamenti në pronësinë tonë, as garazhi (send aksesori) s’ mund të regjistrohet”*. Komisioni ka konkluduar se kjo pasuri është blerë me pagesë të menjëhershme nga EKB-ja dhe kjo e fundit është zhveshur nga e drejta pronësisë, si rrjedhojë subjekti nuk ka pasur pengesë ligjore për regjistrimin e pronësisë garazh dhe kjo situatë e vendos në kushtet e një deklarimi të pasaktë. Lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se mosregjistrimi i një pasurie, e cila është deklaruar rregullisht nga subjekti i rivlerësimit, nuk përbën pasaktësi, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, që të shkojë në parashikimet e ndonjë prej pikave të parashikuara nga neni 33 i ligjit nr. 84/2016.

13.8. Komisioni konstatoi se pasuria objekt kontrolli duket se është përfituar nga subjekti, meqenëse bashkëshorti i saj kishte statusin *i pastrehë*, ndërkohë që ata kanë qenë bashkëpronarë në një pasuri tjetër, të llojit apartament banimi. Apartamenti i banimit dhe pasuria garazh janë dhënë me qira nga subjekti i rivlerësimit, çka i përforcoi bindjen Komisionit se subjekti ka përfituar në mënyrë të padrejtë këtë pasuri dhe se është përdorur prej saj për qëllime tregtare dhe jo për banim, duke i kaluar edhe barrën e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, sqaroi se: *“Marrja e statusit të të pastrehut nga ana e bashkëshortit tim, më pas marrja e autorizimit me vendim të Këshillit Bashkiak, janë bërë më vonë pasi unë dhe bashkëshorti im dhuruam pjesën në banesën e prindërve të mi. Teknikisht nuk ka ekzistuar pengesë, ndërsa kishim nevojë për një banesë tjetër pavarësisht përfitimeve që kishte jetesa e përbashkët me prindërit, në drejtim të kursimit të parave. Në bazë të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për*

kontributin e shtetit për familjet “e pastreha”, ne s’mund të përfitonim, vetëm nëse po sipas këtij ligji, rasti ishte i ndaluar. Kriteret ndaluese të tij ishin parashikuar në nenin 12 të tij”. Lidhur me gjetjen e Komisionit, mbi përdorimin e kësaj pasurie për qëllime tregtare (qiradhënie) dhe jo për banim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “Dhënia me qira u bë për shkak të joshjes së parave, por edhe për shkak se isha me fëmijë të vogël dhe bashkëshorti pothuaj nuk vinte në banesë për shkak të punës dhe më duhej ndihma e prindërve. Ligji nuk ka pasur ndonjë ndalim për të dhënë me qira sendin e përfituar me kredi. Unë s’mund ta dija, pa e marrë shtëpinë, se do ta jepja me qira”.

13.9. Lidhur me apartamentin e përfituar nga EKB-ja, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, për të përfituar nga ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit në familjet e pastreha”, nuk duhej të figuronin me pasuri në pronësi, ndaj kanë hequr dorë nga një pasuri tjetër ku ishin bashkëpronarë, si dhe prej tyre është kryer ky veprim juridik me qëllim përfitimin e statusit të *pastrehë*. Ky qëndrim i Komisionit mbështetet edhe në faktin se gjatë hetimit administrativ rezultoi që kjo pasuri është dhënë me qira që në momentin fillestar kur është marrë në përdorim dhe nuk është shfrytëzuar nga subjekti dhe familja e saj për strehim.

13.10. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në informacionin⁶ që EKB-ja i ka dërguar Komisionit, me kërkesën e këtij të fundit, ka bashkëlidhur dokumentacion, në të cilin gjendet edhe vërtetimi me nr. {***} prot., datë 10.11.1997, i Bashkisë Tiranë, sipas së cilit bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. A., ka përfituar statusin e të pastrehut me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 144, datë 29.09.1997, në bazë të VKM-së nr. 49, datë 29.01.1993, “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”.

Në pikën 1 të kësaj VKM-je parashikohet se:

“1. Të quhen të pastrehë:

a) Qytetarët që nuk kanë kontratë me ndërmarrjen komunale të banesave, si:

- Të qarkulluarit e të transferuarit, të cilët e kanë zgjidhur kontratën e qirasë.

- Qytetarët që përbëjnë familje të veçanta brenda trungut dhe që sipas gjendjes ekzistuese të strehimit nuk janë qiramarrës e nuk disponojnë një dhomë, kur kanë një fëmijë nën 10 vjeç, ose kur kanë një dhomë me një fëmijë mbi 10 vjeç (për këtë kategori dhomë do të quhet edhe kuzhina).

b) Qytetarët që janë me banim të përkohshëm në ndërtesa, të cilat nuk hyjnë në fondin e banesave, si konvikte, shkolla, hotele, qendra administrative etj.

c) Qytetarët që banojnë nëpër bodrume, banesa që nuk përmbushin kushtet higjieniko-shëndetësore, pa banja, instalime hidrosanitare etj.

ç) Qytetarët që banojnë në banesa shtetërore ish-pronë private, si dhe ata qytetarë që banojnë si qiramarrës në banesa private.

d) Qytetarët që, si pasojë e vendimeve gjyqësore, rezultojnë me strehim të përkohshëm. [...]”.

⁶ Shkresë nr. {***} prot., datë 15.05.2021, e EKB-së.

13.11. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në pyetësorin standard të Komisionit se me bashkëshortin A. A. ka lidhur martesë ligjore në vitin 1986 dhe meqenëse nuk kishin banesë kanë vazhduar të jetojnë me prindërit e subjektit në një ekonomi të përbashkët, në apartamentin e tyre në rrugën “{***}”, Tiranë. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka jetuar në këtë apartament bashkë me familjen e saj deri në vitin 2016.

Komisioni vlerësoi edhe këtë apartament në pronësi të prindërve Xh. dhe S. A., me sipërfaqe totale 72,60 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “AShK”) ka konfirmuar⁷ për Komisionin se kjo pasuri është në bashkëpronësi të shtetasve Xh. dhe S. A., prindërit e subjektit të rivlerësimit, duke bashkëngjitur shkresës dokumentacionin e disponuar. Kolegji vëren se më datë 19.07.1993 është nënshkruar kontrata për privatizimin e banesës, me palë Ndërmarrjen Komunale të Banesave dhe qiramarrës z. Xh. A.. Bashkëngjitur gjendet mandatarëtimi nr. {***}, datë 19.07.1993, nëpërmjet të cilit është paguar vlera e privatizimit prej 10.840 lekësh. Rezulton se është nënshkruar (pa datë) edhe kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie me palë blerëse Xh. A., S. A., A. A. dhe Kaçe Agolli. Sipas kartelës së pasurisë rezulton se ky apartament është regjistruar në datën 26.11.1998, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit dhe prindërve të saj, ndërsa, po sipas kësaj karte, në datën 09.02.2000 ky apartament figuron me bashkëpronarë vetëm prindërit e subjektit të rivlerësimit Xh. dhe S. A.. Nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 05.06.1996, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj i kanë dhuruar Xh. dhe S. A. pjesën e tyre takuese në këtë pasuri, pa kundërshtim, duke i dhënë fund bashkëpronësisë mbi apartamentin. Në përmbledhje të sa më sipër, ky apartament është privatizuar në vitin 1993 dhe është regjistruar në pronësi të subjektit, prindërve dhe bashkëshortit të saj. Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë dhuruar pjesën e tyre të bashkëpronësisë prindërve të subjektit në vitin 1996 e më pas janë trajtuar me statusin e të pastrehut, duke përfutur apartamentin me sip. 92 m² nëpërmjet EKB-së.

13.12. Kolegji sjell në vëmendje se në nenin 9, paragrafi i parë i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” (në vijim ligji nr. 7652/1992), i shfuqizuar, parashikohet se: *“Banesat që privatizohen, do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij”*. Sipas kësaj dispozite përfitojnë pjesë takuese tek apartamenti anëtarët madhorë në momentin e privatizimit. Në nenin 13 të ligjit të mësipërm parashikohet se: *“Qiramarrësi që ka dhoma të tepërta, ka të drejtë që, nëpërmjet organit kompetent shtetëror, të bëjë këmbimin e apartamentit, në mënyrë, që t’u përgjigjet normave ekzistuese të strehimit”*. Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, në vitin 1990 kishte lindur vajza e subjektit (S. A.), që do të thotë se në momentin e privatizimit të apartamentit të prindërve të subjektit të rivlerësimit, njësia familjare faktike e subjektit bashkë me prindërit, përbëhej prej 5 anëtarësh, por në dokumentacionin⁸ e privatizimit të dërguar në Komision nga EKB-ja rezulton një certifikatë familjare në dukje e paplotësuar, pa të dhëna për familjarët. Nga Komisioni nuk është kryer hetim për dokumentacionin e dorëzuar nga bashkëshorti i

⁷ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2020.

⁸ Shkresë nr. {***} prot., datë 15.05.2021, e EKB-së.

subjektit të rivlerësimit për përfitimin e statusit të pastrehut, para marrjes së Vendimit nr. {***}, datë 29.09.1997, të Këshillit Bashkiak Tiranë.

13.13. Në nenin 23, paragrafi i parë, i ligjit nr. 7652/1992, parashikohet se: “*Me zbatimin e këtij ligji, në asnjë rast qytetari nuk mund të bëhet njëkohësisht pronar i dy banesave shtetërore*”. Duket se parashikimi ndalues i kësaj dispozite ka bërë që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, për të përfituar statusin “i pastrehë”, duhej të figuronin pa banesë, si rrjedhojë në vitin 1996 i dhuruan prindërve të subjektit pjesën e tyre të përfituar në vitin 1993 nga privatizimi i apartamentit.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në ankim se babai i saj i ka vendosur emrin në çastin e privatizimit pa e pyetur subjektin më parë. Në vijim, subjekti dhe bashkëshorti i saj e dhuruan pjesën e tyre përsëri te prindërit e saj dhe kryen procedurat e aplikimit për statusin e të pastrehut, për arsye se nuk ndiheshin komodë të jetonin dy kurorë në të njëjtën banesë.

Në ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, aktualisht i shfuqizuar (në vijim “ligji nr. 8030/1995”), neni 1 parashikonte: “*Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë detyrimet financiare të shtetit për të pastrehët që rezultojnë nga zbatimi i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe akteve nënligjore të tij, si dhe mënyrën e dhënies së kredisë për ta, duke lehtësuar zgjidhjen e strehimit të tyre dhe duke krijuar mundësi për të përfituar edhe nga tregu i lirë i tokës dhe banesave*”. Sipas këtij neni, qëllimi i ligjit ishte të sistemojë të pastrehët, të cilët nuk kanë përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, duke zgjidhur çështjen e strehimit nëpërmjet dhënies së kredisë, për t’iu krijuar mundësi të përfitojnë nga tregu i lirë i banesave. Pra, sipas këtij parashikimi, subjekti i rivlerësimit nuk mund të përfitonte nga ky ligj (nr. 8030/1995), për të marrë kredi nga shteti, edhe pse i ka dhuruar prindërve pjesën takuese bashkë me bashkëshortin, për shkak se ka qenë përfituese sipas ligjit nr. 7652/1992, duke u bërë bashkëpronare me prindërit dhe bashkëshortin e saj në apartamentin e privatizuar në vitin 1993. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit, edhe pse në momentin që ka aplikuar për statusin e të pastrehut figuronte pa banesë, bashkë me bashkëshortin e saj nuk ishin subjekte përfitues sipas ligjit nr. 8030/1995.

13.14. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë dhuruar në vitin 1996 pjesën e tyre takuese bashkëpronarëve të këtij apartamenti, prindërve të saj, me qëllimin për të plotësuar kriteret e parashikuara në VKM-në nr. 49, datë 29.01.1993, “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët” (cituar në paragrafin 13.10 më sipër). Subjekti i rivlerësimit duket se ka përfituar apartamentin në rrugën “{***}”, Tiranë, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe qëllimin e ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” (paragrafi më sipër), pasi, edhe pse në momentin e përfitimit të këtij apartamenti nuk figuronte të kishte pasuri tjetër, ajo kishte përfituar pasuri nga ligji i privatizimit, pavarësisht se e dhuroi atë. Lidhur me sa më sipër, nga situata faktike e rezultuar, duket se veprimet e subjektit të rivlerësimit kishin për qëllim përfitimin e statusit të pastrehut për të fituar pasuri të ndërtuar me fonde publike, ndërkohë që më parë kishte përfituar nga ligji i privatizimit pasurinë në bashkëpronësi me prindërit. Veprimi juridik i vetëm i kryer prej subjektit të rivlerësimit, i cili ka mundësuar edhe vendosjen e

situatës në favor të saj, është ai i dhurimit në vitin 1996 të pjesës takuese të apartamentit në bashkëpronësi me prindërit. Nga të dhënat e administruara në fashikull rezulton se ky veprim juridik është kryer ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrën e gjyqtarit. Si rrjedhojë, pavarësisht problematikave të rezultuara në përfitimin e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur veprimet për përfitimin e pasurisë i ka kryer gjatë kohës kur ka ushtruar detyrën e ndihmës gjyqtare dhe jo në detyrën e gjyqtare, për rrjedhojë dhe përgjegjësitë profesionale nuk i përkisnin kësaj detyre, trupi gjykues vlerësoi se këto veprime nuk kualifikohen si të tilla që do të preknin etikën apo detyrimet e saj profesionale si gjyqtare dhe nuk mund të kategorizohen sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14. ***Lidhur me ndërtimin e shtesës anësore të apartamentit***, me nr. pasurie {***}, ndodhur në rrugën “{***}”, objekt i cili është ndërtuar ngjitur në apartamentin ekzistues të përfituar nëpërmjet EKB-së, subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është alogjik. Në këtë objekt, secili prej banorëve të pallatit ka investuar për ndërtimin e një shtese banimi në apartamentet respektive. Burimi i krijimit të shtesës së apartamentit, sipas deklaratës *vetting*, janë të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit në rrugën “{***}”, në shumën 600 USD/muaj dhe kursimet familjare. Pjesa takuese: 100%, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

14.1. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë shtesën anësore të apartamentit, në emër të nënës S. A., deklaruar në faqen “të dhëna konfidenciale”, në rubrikën për personat juridikë, si dhe personin e besuar.

Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Nga legalizimi kam në pronësi time një apartament (shtesë anësore) të ndodhur në rrugën “{***}”, të cilën e kam trashëguar nga nëna ime S. A. gjatë procesit të legalizimit. Këtë deklaram e kam bërë edhe më parë. Marr qira mujore 30.000 lekë*”.

Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Në bazë të vërtetimit të pronësisë nr. {***}, në rrugën “{***}”, aplikimi për legalizimin e të cilit është bërë nga nëna ime S. A., por në momentin e legalizimit ajo kishte ndërruar jetë. Si rrjedhojë, bazuar në dëshminë e trashëgimisë, u regjistrua në ZVRPP-në Tiranë në pronësinë time [...]*”. Burimi i krijimit, sipas deklaratës *vetting* (shënuar me shkrim dore): “*Shpenzimet janë përballuar nga qiraja e apartamentit bashkëshortor me kredi (firma {***}) 600 dollarë në muaj dhe kursimet familjare [...]*”. Pjesa takuese: 100%, në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, arsyeja e këtij veprimi ishte në respektim të dëshirës së nënës së saj për ta pasur në trashëgimi djali i saj.

14.2. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se AShK-ja ka informuar⁹ Komisionin se aplikimi për legalizimin e kësaj shtese apartamenti me sip. 87,2 m² është kryer nga nëna e subjektit, znj. S. A., ku sipas formularit të vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës anësore është depozituar pranë ALUIZNI-t, më datë 10.10.2006. Ky formular është nënshkruar nga banorët e pallatit, si dhe nëna e subjektit të rivlerësimit. Nëna e subjektit ka ndërruar jetë

⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 06.03.2020.

më datë 14.07.2007. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë¹⁰, subjekti i rivlerësimit është përcaktuar trashëgimtare e vetme ligjore. Në zbatim të VKM-së nr. 1134, datë 18.11.2009, “Për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”, i ndryshuar, është bërë kalimi në pronësi të poseduesve të shtesës së pallatit, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 09.03.2011, për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore me sipërfaqe 86,3 m² me palë shitës ALUIZNI dhe palë blerës banorët e pallatit, ku përfshihet edhe emri i subjektit të rivlerësimit. Vlera e parcelës ndërtimore rezulton të jetë 305.642,80 lekë dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë 299.249 lekë. Leja e legalizimit nr. {***}, datë 30.06.2011, është miratuar për objektin shtesë anësore 7 kate, e kombinuar në godinën ekzistuese 5 kate, me sipërfaqe parcele ndërtimore 86,3 m², në emër të banorëve posedues, ku bën pjesë edhe emri i subjektit të rivlerësimit. Sipas certifikatës së pronësisë së kësaj pasurie, kjo shtesë anësore është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 13.01.2012.

14.3. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit të përfituar nga EKB-ja, shoqërisë farmaceutike “{***}”, me vlerë 600 USD në muaj, si dhe kursimet familjare, si rrjedhojë e jetesës me prindërit në ekonomi të përbashkët. Në formularin e vetëdeklarimit dorëzuar pranë ALUIZNI-t nuk rezulton e përcaktuar periudha kohore e ndërtimit dhe as kostoja e këtij investimi. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit të datës 02.06.2021, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë formularin e vetëdeklarimit të shtesës anësore, preventivin e punimeve, si dhe burimin e të ardhurave të përdorura për këtë ndërtim. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ndërtimi i shtesës së apartamentit ka filluar në vitin 1999 dhe ka përfunduar në fund të vitit 2001. Sipas preventivit të kësaj shtese ndërtimi me sipërfaqe 87,20 m², rezulton se vlera totale e tij është 2.814.310 lekë.

14.4. Në këtë periudhë kohore, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kishin dhënë me qira shtesën e apartamentit shoqërisë “{***}”, sipas kontratës së qirasë dyvjeçare me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.07.1998, me qira mujore 600 USD, me kohëzgjatje deri më 15.08.2000, si dhe kontratës së qirasë njëvjeçare me nr. {***} rep., (nuk është shënuar nr. kol.), datë 17.11.2000, me qira mujore 600 USD, me kohëzgjatje deri më 15.08.2001. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar edhe disa procesverbale në formën e shkresës së thjeshtë, të cilët janë mbajtur në ditën kur është paguar qiraja nga ana e qiramarrësit, si dhe janë sigluar edhe nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Procesverbalet i përkasin periudhës 15.11.1998-14.10.2000 dhe pasqyrojnë muajin dhe shumën e paguar të qirasë. Disa muaj mungojnë, ndërsa disa të tjerë janë të dubluar 2-3 herë për të njëjtin muaj. Në faqen pas procesverbaleve janë fotokopjuar edhe disa mandatarkëtime, të cilat i përkasin pagesës së qirasë për muajin e përcaktuar në këto procesverbale. Mandatpagesat përmbajnë numrin dhe datën e mandatit, shumën 600 USD, muajin që është paguar dhe nënshkruesit shoqëria “{***}” dhe qiramarrësit A. e Kaçe Agolli. Nga përmbajtja e këtyre dy kontratave është parashikuar pagesa e qirasë nga shoqëria “{***}”, në shumën 600 USD, pa specifikuar *bruto* apo *neto*, si dhe pa një parashikim

¹⁰ Dëshmia e trashëgimisë lëshuar me vendimin nr. {***}, datë 22.06.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

për pagesën e detyrimeve tatimore. Vetëm shpenzimet për energji elektrike, ujë dhe telefon, janë përcaktuar se janë në ngarkim të qiramarrësit. Gjithashtu, në dosje gjenden të administruara edhe disa kontrata të tjera qiraje¹¹, të cilat janë lidhur ndërmjet qiramarrësve të tjerë dhe subjektit të rivlerësimit.

Për të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e apartamentit shoqërisë farmaceutike nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, që përbëjnë në total vlerën prej 21.600 USD për periudhën 1998-2001, Komisioni konkludoi se nuk është paguar detyrimi i tatimit në burim, duke mos i përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1999-2001, për mundësinë e krijimit të shtesës së apartamentit me burime financiare të ligjshme. Nga kjo analizë Komisionit i rezultoi se duke konsideruar si vlerë të investimit për ndërtimin e shtesës shumë 2.814.310 lekë¹², sipas deklaramit në pyetësor të subjektit të rivlerësimit, nuk mund kryente investimin për një diferencë negative në shumën (-) **2.818.910 lekë**.

14.5. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi konstatoi se:

i) *Kjo pasuri është një ndërtim pa leje dhe deklarimi për regjistrim i saj nga mamaja e subjekti të rivlerësimit duket se është bërë për të shmangur këtë veprim të kryer nga subjekti i rivlerësimit me cilësinë e gjyqtarit.*

ii) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën vetting dhe as në DPV vlerën totale të investimit për ndërtimin e kësaj pasurie. Referuar vlerës së deklaruar gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me burime të ligjshme për të ndërtuar apartamentin 87,2 m² në vlerën e deklaruar prej tij në shumën 2.814.310 lekë.*

iii) *Të ardhurat nga qiraja të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 14.400 dollarë të përdorura për ndërtimin/investimin e kësaj pasurie nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, ndaj deri në këtë moment nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare si burim për këtë pasuri.*

14.6. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Në komentarin e përgatitur nga Ekspertët e Lartë të Reformës në Drejtësi citohet se: “Të ardhurën e ligjëron burimi i krijimit¹³. Një e ardhur nuk klasifikohet në sistemin financiar si e paligjshme, nëse mbi të nuk janë paguar taksa. Ligjshmëria e pasurisë, përgjatë gjithë legjislacionit fiskal të kontrollit të pasurive ose të pastrimit të parave, lidhet me burimin e krijimit dhe jo me pagesën tatimore mbi këto të ardhura. [...] Formulimi se “pasuri të ligjshme janë të ardhurat e deklaruara dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore” është një kombinim që kërkon interpretim”. Siç u arsyetua më lart, nëse do të pranohet se “pasuri e ligjshme” (pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme) është vetëm ajo për të cilën janë paguar tatimet, atëherë ky qëndrim do të injoronte padrejtësisht një sërë zhvillimesh ligjore në Shqipëri, që kanë legjitimuar pasuri, edhe në rastin kur ato kanë pasur parregullsi sipas ligjit tatimor dhe jo

¹¹ (i) Kontratë qiraje nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 31.01.2007, me qiramarrës znj. L. J. G., me afat qiradhënie 1-vjeçar (01.08.2006-31.07.2007) dhe qira mujore 250 USD; (ii) kontratë nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 19.01.2015, me qiramarrës A. dhe S. K., me afat 1-vjeçar (01.08.2014-31.07.2015) dhe qira mujore 30.000 lekë/muaj.

¹² Vlera e investimit të llogaritur nga Komisioni, sipas metodës së EKB-së, rezulton në shumën 2.315.062 lekë, por Komisioni konsideroi deklaramit të subjektit të rivlerësimit për koston e investimit të shtesës anësore.

¹³ Pika 17 faqe 532 e komentarit mbi reformën në drejtësi.

deklarimit ose pagimit të taksave mbi këto të ardhura". Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit shpjegon se, bazuar në ligjin e kohës nr. 8438, datë 31.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe parashikimit të tij në nenin 33, detyrimi për të paguar tatimin në burim ka qenë i shoqërisë qiramarrëse.

14.7. Me prapësimet e barrës së provës, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision vërtetimin nr. {***} prot., të datës 12.08.2021, të Gardës së Republikës, lëshuar për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, sipas së cilit rezultoi se ka përfituar të ardhura si punonjës i Gardës së Republikës, nga viti 1992 deri në vitin 2013. Sipas këtij vërtetimi, për periudhën 1990-2006, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është trajtuar me veshje të gatshme civile si pallto, kostum, këmbis, këpucë dhe doreza. Vlera e uniformës për këtë periudhë nuk mund të përcaktohet, sepse nuk gjenden çmimet e tyre.

Gjithashtu, në këtë vërtetim përcaktohet edhe se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995-2003 është trajtuar me artikuj ushqimorë në natyrë, por pa përcaktuar vlerën e përfituar për këtë kompensim.

Komisioni kreu ripërlllogaritje të analizës financiare, sipas së cilës u ndryshua diferenca negative nga (-) 2.818.910 lekë në (-) 1.849.718 lekë, duke zbritur vlerën 969.192 lekë, me arsyetimin e dhënë në vendim se ka zbritur nga shpenzimet jetike për familjen ato që i përkasin bashkëshortit të subjektit. Kjo zbritje e kryer nga Komisioni rezultoi se është mbi vlerën e shpenzimeve jetike për një anëtar të familjes së standardit të përdorur në ILDKPKI, pra, ka kryer një përlllogaritje tepër garantiste për shpenzimet jetike të familjes së subjektit të rivlerësimit.

14.8. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, subjekti deklaroi se të ardhurat nga kontratat e qirasë, të cilat kanë shërbyer si burim për të ndërtuar shtesën e apartamentit, i përkasin periudhës 24.07.1998 - 15.08.2001, të ardhura të cilat trupi gjykoes ia nënshtroi shqyrtimit në Kolegj për të vlerësuar nëse janë të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se i ka deklaruar këto të ardhura dhe se nuk është bërë me dije asnjëherë se për to duhet të paguhej tatim. Gjithashtu, subjekti shpjegon se qiramarrësi ishte person juridik, mbajtës i një numri NIPT, ka deklaruar shpenzimin e qirasë dhe për këtë institucionet shtetërore nuk ka i kanë kërkuar mbledhje të tatimit. Subjekti pretendon se fakti që qiramarrësi, person juridik, nuk ka paguar tatimin mbi qiranë nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit.

14.9. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, Kolegji konsideroi me rëndësi kryerjen e një analize juridike lidhur me kuadrin ligjor të kohës që normonte çështjet e pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale, me qëllim interpretimin e duhur të parashikimeve kontraktuale. Sipas legjislacionit të analizuar, rezultoi se në ligjin e kohës nr. 7786, datë 27.01.1994, "Për tatimin mbi të ardhurat personale"¹⁴, në nenin 2¹⁵ parashikohen kategoritë e të ardhurave të tatueshme,

¹⁴ I shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat".

¹⁵ Neni 2 parashikon: "Kategoritë e të ardhurave të tatueshme janë këto: 1. Pagat. 2. Shpërblime për shërbime individuale. 3. Të ardhurat nga konkurset dhe lotaritë. 4. Të ardhurat nga qiratë e banesave, dyqaneve, magazinave, tokës dhe objekteve të tjera".

të cilat përfshijnë edhe qiratë për banesat. Në nenin 6¹⁶ të këtij ligji parashikohet edhe shkalla tatimore në masën 20% për këtë kategori të ardhurash. Në nenin 7 parashikohet: “Çdo individ a ndërmarrje që përfiton shërbime si nga marrëdhëniet i punësuar - punësues, ashtu edhe nga marrëveshje për shërbime individuale, mban tatimin për të ardhurat personale dhe e derdh atë në buxhetin e shtetit, në të njëjtën kohë me tërheqjen e pagesave, sipas mënyrës së përcaktuar nga Ministria e Financave”. Sipas këtij parashikimi, pala që ka përfituar të ardhurën nga shërbimi është pala qiradhënëse, e cila duhet të mbante tatimin dhe ta paguante atë në organet shtetërore të autorizuar për mbledhjen e tatimeve, me destinacion buxhetin e shtetit. Duke qenë se të ardhurat nga qiraja përbëjnë të ardhur personale të qiradhënësit, agjenti për mbledhjen e tatimit për fitimin e gjeneruar nga këto të ardhura (për periudhën nga 24.07.1998-15.01.1999), ishte qiradhënësi në këtë rast, edhe për faktin se ligji në atë kohë nuk parashikonte agjent për mbledhjen e tatimit.

14.10. Ky detyrim, sipas arsyetimit më sipër, i shtrin efektet deri në miratimin e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (në vijim “ligjit nr. 8438/1998”), aktualisht i shfuqizuar, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit¹⁷ në Fletoren Zyrtare, me 15 janar të vitit 1999, i cili në nenin 4, shkronja “gj”, ndër të tjera, parashikohet si burim të ardhurash edhe qiraja. Gjithashtu, në nenin 8, shkronja “d” të këtij ligji, parashikohet si e ardhur e tatueshme edhe e ardhura nga qiraja. Në pikën 2¹⁸ të nenit 9, me titull “Tarifat tatimore”, të ligjit të mësipërm, parashikohet se të ardhurat nga qiraja futen në kategorinë e të ardhurave që taten në masën 10%. Pra, sipas ligjit të kohës, kur janë krijuar këto të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit në rrugën “{***}”, qiraja parashikohej si një e ardhur e tatueshme, e cila kishte shkallë tatimore në masën 10%. Në versionin fillestar të ligjit të mësipërm, që i përket kohës së përfitimit të këtyre të ardhurave, sipas nenit 33, që parashikon rastet kur mbahet tatimi në burim i të ardhurave, qiraja nuk përfshihet. Subjekti i rivlerësimit shpjegon në ankim se qiramarrësi ishte person juridik, mbajtës i një numri NIPT dhe ka deklaruar shpenzimin e qirasë e, për këtë, organet shtetërore nuk i kanë kërkuar pagimin e tatimit. Subjekti i rivlerësimit sqaroi në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, si dhe në ankim se ndryshimet e ligjit nr. 8438/1998, në vitin 2001, kanë përfshirë edhe të ardhurat nga qiraja si tatim, i cili mbahet në burim, në pikën “d” të nenit 33 të këtij ligji, duke pretenduar se detyrimin për pagesën e tatimit për të ardhurat nga qiraja e kishte shoqëria qiramarrëse e apartamentit. Kolegji konstatoi se ligji nr. 8841, datë 11.12.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438/1998”, i cili ka përfshirë pagesat e qirave në nenin 33, shkronja “d”¹⁹, si lloj i tatimit që mbahet në burim, në masën 15%, për

¹⁶ Neni 6 parashikon: “Tatimi mbi të ardhurat personale për veprat krijuese është 5 për qind dhe për llojet e tjera të të ardhurave personale është 20 për qind”.

¹⁷ Botuar në Fletore Zyrtare më 31.12.1998, sipas të dhënave të QBZ-së.

¹⁸ Neni 9, pika 2 parashikon: “[...] qiratë apo kontratat e tjera, të ngjashme me të, enfiteoza, të ardhurat nga e drejta e autorit apo pronësia intelektuale, si dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera, që nuk janë parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, taten me 10 për qind”.

¹⁹ Neni 33 i ligjit nr. 8438/1998 parashikon: “1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe çdo subjekt tjetër, i njohur si i tillë nga legjislati në fuqi, mban në burim tatimin, në masën 15 për qind, për pagesat e mëposhtme:

a) dividendët, përveç dividendëve të përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 34 të këtij ligji;

b) ndarjet e fitimit, përveç ndarjeve të fitimit të përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 34 të këtij ligji;

personat rezidentë dhe jorezidentë, ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2002, kohë që subjekti i rivlerësimit e kishte përfunduar marrëdhënien e qirasë me shoqërinë “{***}”, për më tepër subjekti nuk provoi formën juridike të kësaj shoqërie. Nga verifikimi i parashikimeve kontraktuale (cituar në paragrafin 14.4 më sipër), rezulton se palët nuk kanë parashikuar në kontratën e qirasë përkatësinë e detyrimeve tatimore për qiranë, por është përcaktuar vetëm çmimi i saj në vlerën 600 USD, pa përcaktuar nëse është *bruto* apo *neto*, çka do të thotë që palët do të zbatonin përcaktimet ligjore të kohës. Nga procesverbalet për pagesën e qirasë, si dhe mandatarëtimet bashkëngjitur del qartë se pagesa e qirasë është paguar në masën *bruto* nga shoqëria. Në këtë rrethanë, subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhurën nga qiraja në masën *bruto*, pasi dokumentacioni që provon shumën e paguar të qirasë i korrespondon çmimit të saj të dakordësuar ndërmjet palëve në kontratat e qirasë, duke krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni se vlerën e qirasë e merrte *bruto* (pa iu zbritur tatimi), duke mos qenë e besueshme në versionin e pretenduar prej saj, sipas së cilit përmbushja e detyrimit tatimor për të ardhurat e përfituara kryhej nga qiramarrësi.

14.11. Përveç sa më sipër, për të kuptuar statusin juridik të shoqërisë qiramarrëse, në Kolegj u verifikua faqja *online* e QKB-së, në të cilën rezultoi se subjekti tregtar “{***}” është regjistruar në datën 13.06.1996, me përfaqësues z. I. T.. Sipas ekstraktit historik, ky subjekt ka ndryshuar adresë selie në datën 23.06.1999, në adresën rruga “{***}”, që përkon me adresën e apartamentit të subjektit të rivlerësimit. Aktiviteti që ushtron, sipas vendimit nr. {***}, datë 28.03.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është zyrë përfaqësimi e shoqërisë aksionare “{***}”, në Tiranë. Fusha e veprimtarisë, sipas ekstraktit historik në QKB, është shënuar: “*Promovimin e ilaçeve, të prezantojë dhe të bëjë të njohur {***} në Autoritetet Mjekësore Shqiptare, të përhapë produktet e {***}, të sensibilizojë dhe të informojë publikun rreth produkteve të {***}*”. Nga të dhënat e këtij ekstrakti dhe dokumentet e ngarkuara nuk kuptohet statusi juridik i zyrës së përfaqësimit të shoqërisë “{***}”. Në sistemin e QKB-së gjendet i ngarkuar një dokument i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Tiranë²⁰, sipas së cilit subjekti “{***}”, me formë juridike “Zyrë përfaqësie”, ka likuiduar detyrimet vendore për vitin 2009, sipas legjislacionit në fuqi. Rezulton vetëm një bilanc i shoqërisë i vitit 2009 në QKB, i cili është me vlerë 0 (zero) dhe, siç është sqaruar në të, është hartuar për efekt të likuidimit të shoqërisë “{***}”.

c) interesat, përveç interesave të bonove të thesarit dhe të letrave të tjera me vlerë, të emetuara nga Këshilli i Ministrave para datës 1 janar 1999, të përcaktuara në paragrafin e tretë të nenit 34 të këtij ligji;

ç) pagesat për të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale;

d) pagesat për shërbime teknike dhe pagesat për menaxhim, si dhe pagesat për qiratë;

dh) pagesat për ndërtim, instalim, montim apo punë mbikëqyrëse, përkatëse, të kryera nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore, apo një individ, gjatë administrimit të veprimtarisë së vet;

e) pagesat për argëtues, artistë apo sportistë në një shfaqje apo prezantim në Republikën e Shqipërisë dhe pagesa të tilla, bërë personave juridikë apo ortakërive, të cilët punësojnë argëtues, artistë apo sportistë apo ndërmjetësojnë shfaqje a prezantime të tilla.

2. Paragrafi i parë i këtij neni zbatohet edhe ndaj jorezidentëve, për pagesa të tilla, të lindura nga një person me seli të përhershme që ai mban në Republikën e Shqipërisë.

[...].”

²⁰ Shkresë nr. {***} prot., datë 10.07.2009.

14.12. Lidhur me pretendimin e subjektit në ankim se dhënia me qira nuk është veprimtari tregtare, pasi s'mund të quhet marrëdhënie tregtare një kontratë civile që nuk konsiderohej e tillë sipas ligjit, vlerësohet se detyrimi për të ardhurat e krijuara nga qiradhënia, pavarësisht marrëdhënies tregtare ose jo, është parashikim i sanksionuar në legjislacionin e hershëm tatimor, si dhe në vazhdim (paragrafët 14.9 dhe 14.10), sipas së cilit përfshihet në llojin e të ardhurave të tatueshme, si rrjedhojë i nënshtrohen detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale. Nga dokumentacioni i administruar në dosje gjendet përgjigjja ²¹ e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar Komisionit, sipas së cilës rezulton se subjekti i rivlerësimit është subjekt i pagesës së tatimit në burim nga data 01.03.2017, duke kryer likuidime për periudhat: mars 2017, maj 2017, prill 2018, mars 2019, dhjetor 2019 dhe janar 2020. Sipas këtij vërtetimi, subjekti i rivlerësimit rezulton tatimpaguese, ka pranuar që ka pasur detyrimin për pagesën e tatimit lidhur me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e banesës, e pa kondicionuar nga veprimtaria tregtare. Argumenti i Komisionit se ky apartament është përdorur për veprimtari tregtare, duket se nuk i përgjigjet veprimtarisë/veprimit juridik të ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit, pasi provohet që ai është përdorur vetëm për ta dhënë me qira prej saj.

14.13. Komisioni ka analizuar edhe të ardhurat nga dhënia me qira e apartamenteve për vitet 2003 – 2015, për të cilat ka vlerësuar se këto të ardhura, në çdo rast, nuk kanë afektuar analizën financiare, e cila rezulton me një balancë pozitive dhe se nuk janë përdorur në blerjen apo krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, duke arritur në konkluzionin se edhe nëse nuk merren në konsideratë, nuk sjellin asnjë nga pasojat e përcaktuara në pikën 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

14.14. Në vlerësim të sa më sipër, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit provoi me kontratat e qirave, cituar në paragrafin 14.4 më sipër, se ka dhënë për një periudhë 3-vjeçare me qira apartamentin e përfituar nga EKB-ja, të ardhurat e përfituara të të cilit pretendon se i ka përdorur për ndërtimin e shtesës anësore. Për këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk kishte asnjë detyrim për pagesën e tatimit, përkundrazi pretendoi se detyrimin për tatimin në burim e kishte shoqëria që kishte marrë me qira apartamentin e subjektit. Kolegji vlerësoi në paragrafin 14.9 më sipër se sipas ligjit të kohës detyrimin për pagimin e detyrimit tatimor e kishte qiradhënësi, pra, vetë subjekti i rivlerësimit në periudhat që ligji parashikonte një detyrim të tillë. Për më tepër, rezultoi se e ardhura e përfituar çdo muaj nga dhënia me qira e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit ishte në vlerën *bruto*, pra, ajo ka qenë në dijeni se për këtë të ardhur nuk po paguhej asnjë tatim, duke mos qenë e besueshme në pretendimin se detyrimin tatimor duhet ta paguante qiramarrësi. Në periudha të ndryshme masa e tatimit për të ardhurat nga qiraja ka qenë përkatësisht 20% dhe 10%, sipas legjislacionit të cituar në paragrafin 14.9 dhe 14.10 më sipër, detyrim tatimor i cili nuk u provua se është paguar nga subjekti i rivlerësimit, në periudhat kur ky detyrim i përkiste qiradhënësit. Bazuar në sa më sipër, të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e apartamentit, të cilat subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se i ka përdorur si burim për ndërtimin e shtesës anësore të këtij apartamenti, nuk plotësojnë kushtet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se të ardhura të

²¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 07.03.2020.

ligjshme janë të ardhurat të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, ndaj, si të tilla, u gjet i drejtë qëndrimi i Komisionit për mos përfshirjen e tyre në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit si të ardhura me burime financiare të ligjshme.

14.15. Gjithashtu, Komisioni ka konkluduar se fakti që shtesa anësore e apartamentit është deklaruar nga nëna e subjektit të rivlerësimit dhe jo prej subjektit që ka paguar shpenzimet për ndërtimin e saj, krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka dashur të shmangë këtë deklaram. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se subjekti e ka deklaruar këtë shtesë apartamenti në deklaratën e vitit 2009 si interes pasuror në emër të nënës (paragrafi 14.1 më sipër), ndërsa në vitin 2012 ka deklaruar të ardhurat nga kjo pasuri të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe në deklaratën *vetting*. Në asnjë nga këto deklarata nuk rezultoi të jetë përcaktuar vlera e investimit të kryer për ndërtimin e kësaj shtese anësore, periudhën kur ajo është realizuar, si dhe burimin për krijimin e saj. Gjithashtu, edhe në formularin e vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t nuk gjendet e deklaruar vlera e investimit e as koha e ndërtimit (paragrafi 14.3 më sipër). Rezulton se në vitin 2009 është deklaruar për herë të parë kjo pasuri, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të Komisionit ka sqaruar se ndërtimi është kryer nga viti 1999 dhe është përfunduar në vitin 2001, pra, ky ndërtim deklarohet gjatë procesit të rivlerësimit se ka përfunduar para deklaratës së parë të pasurisë që i përket vitit 2003, fakt i cili nuk është pasqyruar në këtë deklaram.

14.16. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka sqaruar se shtesa e apartamentit është ndërtuar me shpenzimet e saj, duke deklaruar edhe shumën e shpenzuar për këtë investim (2.814.310 lekë). Në vlerësim të provave të dorëzuara nga subjekti, për të provuar këto të ardhura që kanë shërbyer si burim për investimin e shtesës anësore të apartamentit dhe analizës ligjore lidhur me to, rezultoi se ato nuk përmbushin kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi për to nuk ishin paguar detyrimet tatimore e, si rrjedhojë, nuk u përfshinë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

Nga kontrolli që Kolegji ushtroi në analizën financiare të Komisionit rezultoi se pas rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës, lidhur me të ardhurat nga puna e bashkëshortit të subjektit, Komisioni ka zbritur shpenzimet e jetesës së familjes së saj me një vlerë mbi atë që i përgjigjet shpenzimeve jetike për një anëtar të familjes. Shpenzimet jetike për një anëtar të familjes përfshijnë, jo vetëm shpenzimet për ushqim dhe veshmbathje [siç pretendohet që ka përfituar bashkëshorti i subjektit], por edhe grup shpenzimesh të tjera, të cilat nuk rezultojnë se janë mbuluar në natyrë për të gjithë vitin kalendarik për bashkëshortin e subjektit, nga institucioni i Gardës së Republikës. Vlera e shpenzimit për një anëtar të familjes, për periudhën që pretendohet se bashkëshorti i subjektit ka përfituar shpenzime të mbuluara në natyrë, sipas metodologjisë së ndjekur nga Komisioni do të rezultonte në shumën 591.235 lekë, ndërsa ai e ka përlllogaritur atë në shumën 969.192 lekë, një shumë tejet garantiste, e pambështetur me dokumentacion justifikues ligjor apo financiar. Pavarësisht këtij konstatimi, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, me qëllim mospërkeqësimin e situatës financiare në kuadër të ankimit të paraqitur nga vetë subjekti, lidhur me kontrollin e burimeve financiare të ligjshme për ndërtimin e shtesës së apartamentit, shpenzimet jetike të përlllogaritura nga Komisioni, pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës për bashkëshortin e saj, u konfirmuan edhe në Kolegji.

Si rrjedhojë e sa më sipër, edhe Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të kryente shpenzimet për ndërtimin e shtesës anësore për diferencën negative në vlerën (-) 1.849.718 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

15. **Lidhur me shpenzimin prej 500.000 lekësh**, të marrë kredi më datë 14.01.2016, në Credins Bank, për vajzën e saj, për shpenzime jetese në ShBA, në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se ky është shpenzimi i vetëm i kryer në këtë vit.

Subjekti pretendon se me paraqitjen e një deklarate të znj. R. Q. ka provuar se vajza e saj, znj. S. A., ka qëndruar në shtëpinë e deklarueses që nga viti 2016 e në vijim, në dhomën që kishte tepër në apartamentin e saj. Subjekti ka sqaruar se në një logjikë të thjeshtë, miku nuk paguan për ndenjen dhe kërkon që të intervistohet znj. R. Q. nga ana e Kolegjit në mënyrë të tillë që të vërtetoheshin pretendimet e saj.

Gjithashtu, pretendon se nuk është e drejtë përlogaritja e Komisionit për qiranë e një dhome, në vlerën 1.600 USD në muaj, ndërkohë që vajza e saj paguhet 600 USD në javë. Sipas subjektit të rivlerësimit, standardi i ndjekur për vajzën e saj është i kundërligjshëm dhe dashakeq.

Subjekti ka sqaruar në ankim se marrëdhënia e vajzës së saj me znj. R. Q. është marrëdhënie huapërdorje dhe rregullohet nga nenet 901-912 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

15.1. Konkluzioni i Komisionit për këtë çështje: *“Duke u mbështetur në një analizë financiare hipotetike dhe me shpenzime minimaliste (pasi mund të ketë edhe shumë veprime/shpenzime të tjera të panjohura), si dhe duke pranuar se vajza e subjektit ka përballuar vetë shpenzime për jetesën (ushqimin), rezultati i analizës financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të u rishikua, dhe pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit për vitin 2016 u reduktua në vlerën (-) 2.507.813 (dy milionë e pesëqind e shtatë mijë e tetëqind e trembëdhjetë) lekë”.*

15.2. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Në datën 14.01.2016, kam marrë kredi bankare pranë Credins Bank shumën 500.000 lekë, për shpenzimet e vajzës gjatë praktikës në Departamentin e Operacioneve Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara në New York, ShBA”*

Në DIPP-në e vitit 2016, vajza e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Shpenzime të jetesës gjatë periudhës së praktikës në Departamentin e Operacioneve Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara në New York, ShBA, në shumën 500.000 lekë”.*

15.3. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin standard të Komisionit, ka sqaruar se vajza e saj ka ndjekur *intership* pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në Departamentin e Operacioneve Paqeruajtëse. Për mbulimin e shpenzimeve, subjekti shpjegoi se bashkë me bashkëshortin në cilësinë e dorëzanësit kanë marrë një kredi²² në shumën 500.000 lekë, në Credins Bank. Subjekti shpjegon se vajza e saj ka kryer punë të ndryshme *part-time* për të mbuluar shpenzimet e jetesës, ku ka punuar në dy restorante me kohë të pjesshme në New York dhe për të vërtetuar këto të ardhura ka paraqitur disa çeqe bankare që i përkasin kësaj periudhe.

²² Vërtetim nr. {***} prot., datë 06.06.2016, nga Credins Bank.

Gjithashtu, Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit me pyetësorin e datës 08.07.2021 për shpenzimet e jetesës së vajzës së saj, ku nëpërmjet përgjigjeve të dërguara Komisionit në rrugë elektronike, më datë 12.07.2021, subjekti ka shpjeguar se pas përfundimit të *intershipit* vajza e saj ka vendosur të qëndrojë në ShBA dhe ka qëndruar në shtëpinë e znj. R. Q., pa shpenzime banimi. Subjekti në këtë përgjigje pyetësori ka vendosur në dispozicion të Komisionit mënyrat e kontaktit me znj. R. Q.. Sipas subjektit, vajza e saj ka punuar në dy restorante me kohë të pjesshme dhe për të vërtetuar të ardhurat ka paraqitur disa foto çekesh²³ bankare që i përkasin kësaj periudhe, duke shpjeguar se e ka pasur të pamundur të gjente më shumë, për shkak të periudhës 5-vjeçare të kaluar, si dhe për shkak se këto restorante janë mbyllur në kohën e pandemisë, arsye për të cilën ka paraqitur edhe *print screen* nga faqja e *google*. Subjekti shpjegon se përveç pagesës çek nga restoranti, vajza ka marrë dhe të ardhura në formë *cash*, duke qenë se në ShBA është e zakonshme që punonjësit e restoranteve të marrin një pjesë të madhe të të ardhurve nëpërmjet bakshisheve. Subjekti pretendon se gjatë kësaj periudhe vajza ka punuar edhe në një dyqan këpucësh të ndodhur në New York, ku përsëri është paguar *cash*.

15.4. Totali i këtyre çeqeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit arrijnë vlerën 1.200 USD dhe kjo vlerë është konsideruar në analizën financiare të Komisionit, edhe pse nuk u provua gjatë hetimit administrativ deklarimi dhe pagimi i detyrimeve tatimore lidhur me to në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision, me anë të një *e-mail*-i në datën 08.09.2021, ora 09:53, ditën e seancës dëgjimore, dy çeqe²⁴ të tjera me të njëjtën përmbajtje si çeket e paraqitura me përgjigjet e pyetësorëve në Komision, por me data të ndryshme lëshimi. Këto çeqe nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Komision. Nga kontrolli që ushtroi Kolegji në analizën financiare të Komisionit, këto dy çeqe nuk u konsideruan si shtesë të ardhurash, për shkak se këto të ardhura të pretenduara nga subjekti nuk rezultojnë se janë deklaruar, si dhe nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore për to, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke mos i përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2016. Në dokumentacionin e administruar në dosje nuk gjenden të dhëna të tjera mbi të ardhura të gjeneruara nga vajza e subjektit të rivlerësimit gjatë qëndrimit të saj në ShBA.

15.5. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ se vajza e saj nuk ka pasur shpenzime banimi, Komisioni vlerësoi se nuk ka dokumentacion provues lidhur me qëndrimin e vajzës së subjektit, si dhe mospagimin prej saj të qirasë përkatëse (qëndrimin falas), duke vlerësuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë marrëdhënie në ndonjë deklaram periodik vjetor apo të paraqesë dokumentacion provues mbi ekzistencën e

²³ Çek i lëshuar në 6 korrik 2016 me vlerë 300 USD.
Çek i lëshuar në 15 shtator 2016 me vlerë 200 USD.
Çek i lëshuar në 28 shtator 2016 me vlerë 200 USD.
Çek i lëshuar në 7 nëntor 2016 me vlerë 200 USD.
Çek i lëshuar në 7 dhjetor 2016 me vlerë 100 USD.
Çek i lëshuar në 29 dhjetor 2016 me vlerë 200 USD.
²⁴ Çek i lëshuar më 22 shtator 2016 me vlerë 200 USD.
Çek i lëshuar më 10 gusht 2016 me vlerë 300 USD.

kësaj marrëdhënieje. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi konstatoi se:

- (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën vetting shpenzimet për jetesën e vajzës në New York, si dhe mënyrën e përballimit të tyre. Deklarimet e saj gjatë hetimit nuk përputhen me DPV-të apo me ndonjë dokumentacion ligjor provues.*
- (ii) *Duket se subjekti rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me këto financime duke i fshehur ato.*
- (iii) *Subjekti rezulton në pamundësi financiare në vlerën (-) 3.234.501 lekë, për të përballuar shpenzimet e minimumit jetik së bashku me shpenzimet e qirasë për vajzën e saj gjatë qëndrimit në New York, të llogaritura nga Komisioni deri në këtë moment.*
- (iv) *Subjekti duhet të provojë me dokumentacion ligjor provues mundësitë financiare për përballimin e shpenzimeve të jetesës për vajzën dhe burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave.*

15.6. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Gjatë periudhës së qëndrimit në ShBA vajza ime S. A. ka qëndruar në banesën e znj. R. Q., e cila aktualisht është e punësuar si Drejtoreshë e Programit New Ventures nga {***} në ShBA. Znj. Q. ka në pronësi një banesë në New York. Duke qenë se ajo gjatë javës punon në Baltimore, Maryland dhe kthehet vetëm fundjavave në banesën në New York dhe jeton vetëm, i ka ofruar vajzës të qëndrojë në banesën e saj duke qenë se ka hapësirë të konsiderueshme në banesë. Gjatë kësaj periudhe, vajza nuk ka paguar qira, thjesht ka kontribuar në mirëmbajtjen e apartamentit, duke qenë se znj. Q. nuk qëndron aty gjatë ditëve të javës dhe banesa është praktikisht e pabanuar gjatë javës. Për këtë vendos në dispozicion vërtetimin e nënshkruar nga znj. Q., si dhe dokumente që provojnë se vajza ime S. banon në atë apartament që prej vitit 2016. Gjithashtu, në këtë periudhë ka punuar në disa punë si kameriere part-time në dy restorante në Manhattan, për të cilat disponon disa vërtetime çeqesh, po për shkak se ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nuk disponon të gjithë çeqet që ka marrë [...]”.*

15.7. Subjekti i rivlerësimit, bashkë me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, paraqiti në Komision edhe deklaratën e znj. R. Q., datë 08.02.2021. Në këtë deklaratë në gjuhën angleze sqarohet se: *“Aktualisht jam e punësuar në {***} në ShBA. Nëpërmjet kësaj letre deklaroj se S. A. ka qëndruar me mua si mysafir në dhomën rezervë në apartamentin tim, që nga viti 2016 e deri tani”.* Gjithashtu, znj. R. Q. në deklaratë ka shënuar numrin e telefonit dhe adresën e-mail-it për ta kontaktuar. Ky është i vetmi dokument që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për të provuar që vajza e saj nuk ka pasur shpenzime qiraje gjatë qëndrimit në ShBA. Subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit nuk sqaroi çfarë marrëdhënie shoqërore kishte vajza e subjektit me deklaruesen për të pasur një trajtim të tillë, duke mospaguar qiranë për qëndrimin, si dhe nuk provoi nëse deklaruesja ka në pronësi apartamentin që i ka ofruar për qëndrim vajzës së subjektit të rivlerësimit. Kolegji vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, lidhur me pretendimin për mospasjen e shpenzimeve të qirasë për vajzën, pasi nuk paraqiti asnjë dokument tjetër përpos deklaratës së znj. R. Q., që është hartuar më datë 08.02.2021, e cila nuk mbështetet me asnjë dokument tjetër në proces, qofshin këto të krijuara për efekt të deklarimeve për efekte fiskale në ShBA nga znj. Q. apo edhe vajza e subjektit të rivlerësimit apo deklarim të subjektit të

rivlerësimit e vajzës së saj në DIPP-në e vitit 2016 dhe *vetting*, për rrjedhojë krijon bindjen se deklarata e saj është hartuar për t'i shërbyer subjektit në mbështetje të procesit të saj të rivlerësimit. Nga kërkimet në faqe *online*²⁵, të cilat merren me studime ekonomike në ShBA, qiratë në New York, gjatë vitit 2016, në zonën ku ndodhej apartamenti i znj. Q., nuk kanë qenë më pak se 1.600 USD në muaj për apartamente me një dhomë gjumi. Nga këto të dhëna rezultojnë se shpenzimet e qirasë, për zonën ku banonte vajza e subjektit të rivlerësimit, janë më të larta se shpenzimet e jetesës në prag varfërie për një person, çka e bën të pabesueshme se vajza e subjektit të rivlerësimit jetonte me të ardhurat tepër modeste të përfituara nga puna e saj.

15.8. Kolegji sjell në vëmendje në arsyetim që konkluzioni i Komisionit, sipas së cilit vajza e subjektit kishte përballuar me të ardhurat e saj shpenzimet e jetesës gjatë vitit 2016, duke mos i përlllogaritur shpenzime jetese, të cilat duhet të ishin në shumën 1.549.159 lekë, përveç pagesave për qiranë në masën 1.600 USD në muaj, ishte i pambështetur në prova dhe ligj. Ky qëndrim i Kolegjit bazohet në faktin që i vetmi burim i ligjshëm, i cili plotësonte kërkesat sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ishte kredia në shumën 500.000 lekë e marrë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj. Subjekti i rivlerësimit gjatë procesit administrativ ka deklaruar që puna e vajzës ishte informale, për rrjedhojë dhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara prej saj nuk mund të konsideroheshin si të ardhura të ligjshme, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Komisioni, mbështetur në një analizë financiare hipotetike dhe me shpenzime minimaliste (pasi mund të ketë edhe shumë veprime/shpenzime të tjera të panjohura), si dhe duke pranuar se vajza e subjektit ka përballuar vetë shpenzime për jetesën (ushqimin), rishikoi analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, nga e cila rezultoi se pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit të vajzës për vitin 2016 u reduktua në vlerën (-) 2.507.813 lekë. Kjo diferencë negative e përlllogaritur në analizën financiare në Komision, përfaqëson vetëm shpenzimet e qirasë në vitin 2016 gjatë qëndrimit në ShBA, duke konsideruar se vajza e subjektit ka përballuar vetë shpenzimet e jetesës, megjithëse ato nuk u provuan si të mundshme për t'u mbuluar prej saj.

15.9. Në vlerësim të sa më sipër, Kolegji, edhe pse nuk e gjen të bazuar në prova e ligj analizën e kryer nga Komisioni, lidhur me shpenzimet e jetesës së vajzës së subjektit, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, vlerësoi se nuk u provua se ajo ka qëndruar pa pagesë qiraje në banesën e pretenduar. Mbeti e paprovuar se apartamenti në Manhattan, New York, për të cilin subjekti pretendoi se vajza e saj ka qëndruar pa qira, i përkiste znj. R. Q., si dhe marrëdhënia e posaçme që kishte me të vajza e subjektit, deri në atë nivel sa t'i siguronte asaj qëndrimin falas në apartamentin e saj. Nga kontrolli që ushtroi Kolegji ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, duke i përfshirë si shpenzim

²⁵ <https://www.census.gov/topics/income-poverty/poverty/guidance/poverty-footnotes/cps-historic-footnotes.html>
<https://www.census.gov/programs-surveys/cps/techdocs/cpsmar23.pdf>
<https://www.census.gov/topics/income-poverty/guidance/poverty-measures.html>
<https://www.epi.org/resources/budget/budget-factsheets/#/1886>
<https://www.rentable.co/blog/2016-annual-rent-report-archived/>
<https://www.csrealty.com/rent-charts>

vetëm pagesat e qirasë për vitin 2016 në bazë të parimit *no reformatio in peius*, rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për diferencën negative më së paku në shumën (-) 2.507.813 lekë, situatë e cila e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

16. **Lidhur me të dhënat në formë indicie konfidenciale**, për të cilat Komisioni është vënë në dijeni, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se nuk i është vënë në dispozicion asnjë relacion i relatorit apo i vëzhguesit ndërkombëtar për llojin e informacionit të marrë dhe burimin e tij. Subjekti i rivlerësimi sqaron në ankim se nuk është thënë që vendimi i gjykatës shqiptare do të ekzekutohet vetëm nëse Gjykata e Apelit Amsterdam do ta gjejë me vend apo jo, dhe as është thënë se vendi i ekzekutimit është Holanda. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit pretendon se Gjykata e Apelit Amsterdam ka gjykuar korrektësinë, themelin e çështjes dhe ka zëvendësuar logjikën e gjykatës. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit për këtë çështje nuk është i ligjshëm e as logjik.

16.1. Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje: *“Trupi gjykues, duke e vlerësuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit të Amsterdimit si një qëndrim zyrtar, në fuqi, dhe i marrë nga një institucion i huaj, tërësisht i pavarur dhe i pandikuar nga sistemi i së drejtës shqiptare, si dhe i pandikuar lidhur me situatën aktuale konkrete rivlerësuese të subjektit të rivlerësimit, i konsideron qëndrimet e saj të besueshme dhe vlerëson se me vendimin nr. {***}, datë 24.03.2009, subjekti rivlerësimit ka treguar mungesë dhe dobësi në drejtim të aspektit të njohurive mbi ligjin dhe aftësive për të interpretuar jurisprudencën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, mungesë të elementëve garantist të së drejtës, e se kjo rrethanë duhet vlerësuar në kushtet e nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë”.*

16.2. Komisioni është vënë në dijeni mbi disa të dhëna, të cilat i ka konsideruar indicie konfidenciale, sipas së cilave subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka marrë vendimin nr. {***}, datë 24.03.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet të cilit është vendosur detyrimi i shoqërisë “{***}” për t’i paguar shoqërisë “{***}” ShPK dëmshpërblim në vlerën 25.188.500 euro. Komisioni, për këtë arsye, i ka kërkuar²⁶ Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kopje të vendimit gjyqësor. Kjo e fundit në kthim përgjigjen²⁷ e dërguar Komisionit, për dokumentacionin e kërkuar, ka bashkëlidhur kopje të vendimit nr. {***}, datë 24.03.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kopje të vendimit nr. {***}, datë 28.04.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe kopje të vendimit nr. {***}, datë 07.03.2011, të Gjykatës së Lartë.

16.3. Në vendimin nr. {***}, datë 28.04.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur, sipas dispozitivit të këtij vendimi: *“Detyrimin e palëve të paditura shoqëria “{***}” dega Shqipëri, shoqëria “{***}” spa dhe shoqëria “{***}” spa, që t’i paguajnë palës paditëse shoqërisë “{***}” ShPK vlerën e dëmit jashtëkontraktor në shumën 25.188.500 euro.*

²⁶ Shkresë nr. {***} prot., datë 24.02.2021, e Komisionit për kërkesë informacioni.

²⁷ Shkresë nr. {***} prot., datë 05.03.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*Detyrimin e palëve të paditura shoqëria “{***}” dega Shqipëri, shoqëria “{***}” spa dhe shoqëria “{***}” spa, që t’i paguajnë palës paditëse shoqëria “{***}” ShPK, dëmin jashtëkontraktor për sasinë e energjisë elektrike prej 371.000.000 kwh në vit. Për vitet 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, sipas formulës $Vn=(Q \times Pn)+(Q \times Pcn)$ të përcaktuar në aktin e ekspertimit, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi”.*

Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë palët e paditura, shoqëria “{***}” dega Shqipëri, shoqëria “{***}” spa dhe shoqëria “{***}” spa, e cila, me vendimin nr. {***}, datë 28.04.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 28.04.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pala e paditur ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ku kjo e fundit, me vendimin nr. {***}, datë 07.03.2011, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga të paditurit kundër vendimit nr. {***}, datë 28.04.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 28.04.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

16.4. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime dhe të paraqesë prova për të provuar të kundërtën. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Në atë që ju përmendni, ju thoni se disa juristë Holandezë thonë se vendimi është i pakuptueshëm, ndërsa përmendni ju vetë, përmbajtjen e nenit 608 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Pyesni edhe përse gjykimi është bërë në Shqipëri, ndërsa të paditurit janë subjekte të së drejtës së huaj. Dëshiroj të vë në vëmendjen tuaj se vendimi është i gjatë, por jo i pakuptueshëm. Është i gjatë pasi ka qenë gjykim i komplikuar, ku ndërthureshin institucione të së drejtës, përfshirë edhe elementë të huaj. [...] Nuk arrij dot të kuptoj përse vendimi nga të tjerë juristë jo shqiptarë është cilësuar i pakuptueshëm. Kuptueshmëria s’varet prej meje, në një kohë që vendimi respekton gjithë standardet e detyrueshme nga Kodi i Procedurës Civile. Nëse vendimi ynë do të ishte i pakuptueshëm, Gjykata e Apelit duhet ta kishte prishur. Nëse vendimi ynë dhe i Gjykatës së Apelit do të ishte i pakuptueshëm dhe i pazbatueshëm, Gjykata e Lartë duhet të kishte ndërhyrë dhe t’i prishte të dy vendimet. Kjo s’ka ndodhur e mendoj se në sy të ligjit, ky i fundit është respektuar tërësisht prej nesh në këtë vendimmarrje”.*

16.5. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe qëndrimeve të mbajtura prej saj, Komisioni ka konstatuar se vendimi nr. {***}, datë 24.03.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pjesë e trupës gjykuese të së cilës ka qenë edhe subjekti rivlerësimit, është lënë në fuqi nga të gjitha shkallët e gjykimit, pavarësisht dyshimeve të pretenduara për ndërhyrje. Problematikat që ka referuar Komisioni, në arsyetimin e vendimit të cituar më sipër, janë si në vijim: **(i)** Ky vendim i dhënë nga një gjykatë shqiptare është kërkuar për t’u ekzekutuar (detyrimi i njohur sipas vendimit nr. {***}) nga një gjykatë e huaj, e cila e ka vlerësuar atë të pazbatueshëm, pikërisht për shkak të mënyrës se si është përlloritur detyrimi në raport me situatën faktike dhe legjislacionin shqiptar të zbatueshëm. **(ii)** Nga qëndrimi i Gjykatës së Apelit Amsterdam konstatohet se arsyetimi i përdorur në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe konkluzioni i kësaj gjykate bien ndesh me vetë dispozitat referuese të Kodit Civil Shqiptar dhe vetë qëllimin që ky vendim synon të arrijë, garantimin dhe dëmshpërblimin e drejtë të palëve. Aftësia dhe detyra e një gjyqtari është të zbatojë ligjin dhe ta interpretojë atë krahas

jurisprudencës së detyrueshme, nën frymën e qëllimit të tij, jo në mënyrë të fragmentarizuar e jashtë kontekstit. (iii) Po ashtu, gjykata duhet të ishte kujdesur që të plotësoheshin kriteret në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe që vendimi të ishte i ekzekutueshëm, pasi subjekti vetë ishte në dijeni të ekzistencës së marrëdhënies së palës paditëse me shoqëritë e huaja. Komisioni ka arritur në konkluzion për këtë çështje duke referuar vendimin e Gjykatës së Apelit Amsterdam si një akt zyrtar në fuqi, në të cilin janë dhënë disa reflektime për vendimin nr. {***}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

16.6. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se kundër vendimit nr. {***}, datë 24.03.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë pala e paditur shoqëria “{***}”, ku kjo gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 28.04.2010, ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke arsyetuar se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi, pasi është i bazuar si në ligj ashtu dhe në prova. Pala e paditur ka ushtruar rekurs kundër vendimeve të mësipërme dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 07.03.2011, nuk pranoi rekursin, pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas rrethanave të cituara në këtë paragraf dhe paragrafin 16.3 më sipër, rezulton se vendimi nr. {***}, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kaluar kontrollin e përshkallëzuar gjyqësor të së drejtës së brendshme, të cilat nuk kanë identifikuar zbatim të gabuar të të drejtës shqiptare apo shkelje procedurale [në zbatim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] dhe tashmë përbën një vendim përfundimtar dhe gjë të gjykuar (*res judicata*).

16.7. Në vendimin nr. 2, datë 03.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është arsyetuar se parimi i gjësë së gjykuar (*res judicata*) pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Gjykata ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje e konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra, në cenim të vetë sigurisë juridike. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera²⁸. Kjo lidhet edhe me pandryshueshmërinë dhe forcën detyruese të një vendimi gjyqësor, çka është efekt i drejtpërdrejtë i parimit të sigurisë juridike, në përbërje të të cilit janë parimet e *res judicata* dhe *ne bis in idem*²⁹.

16.8. Duke iu referuar njërit nga kriteret e vlerësimit, që parashikohen në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke mos gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin

²⁸ Vendim nr. 2, datë 16.01.2013, i Gjykatës Kushtetuese.

²⁹ Mbi shkeljen e parimit të sigurisë juridike, shih, Xheraj k. Shqipërisë.

ose logjikën e gjyqtarit, vendimi nr. {***}, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përbërje të trupit gjykues të të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, sa i përket aspektit të njohurive ligjore³⁰, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk evidentohen problematika, konfirmuar kjo edhe me vendimin e Gjykatës së Lartë, në të cilin nuk janë gjetur problematika me ligjin si material ashtu edhe procedural. Sa i përket aspektit të arsytimit ligjor³¹, duket një vendim i strukturuar dhe i mirëorganizuar, ndërsa përmbajtja e arsytimit duket e vështirë për t'u kuptuar, pasi parashikimet e kontratave dhe aktit të ekspertimit të marra në analizë në cilësinë e provave, të cilat përbëjnë faktet dhe rrethanat e konfliktit objekt gjykimi, duke qenë të natyrës tejet teknike e specifike, që i përkasin një fushe që kërkon njohuri të posaçme, mund të kenë ndikuar në drejtim të kuptueshmërisë së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

16.9. Lidhur me problematikën e konstatuar nga Komisioni për arsytimin e vendimit nr. {***}, të cituar në paragrafin 16.5 më sipër, ku Komisioni ka konkluduar se vendimi është kërkuar për t'u ekzekutuar nga një gjykatë e huaj që e gjen atë të pazbatueshëm për mënyrën e llogaritjes së dëmit, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë, pasi rezulton se nga përmbajtja e vendimit, për vitet që është përcaktuar një vlerë dëmi, ai është llogaritur pa zbritur asnjë shpenzim të kryer nga palët në këto vite. Gjykata duket se në urdhërimet për ekspertin nuk i ka caktuar atij detyra për të përlllogaritur edhe shpenzimet e kryera në vitet përkatëse.

16.10. Lidhur me problematikën e konstatuar nga Komisioni për vendimin nr. {***}, cituar në paragrafin 16.5 më sipër, ku ka arsyetuar se konkluzioni i gjykatës bie ndesh me dispozitat referuese të Kodit Civil dhe qëllimin që ky vendim synon të arrijë, trupi gjykues konstaton se në dispozitivin e vendimit nr. {***} është përcaktuar se pala e paditur shoqëria "{***}" detyrohet të paguajë për palën paditëse "{***}" ShPK vlerën e dëmit jashtëkontraktor në shumën 25.188.500 euro, si dhe vlerën e të ardhurave që rrjedh nga fitimi i munguar për periudhën 2005-2011, për sasinë e energjisë elektrike prej 371.000.000 kwh (kilowat për orë) i përlllogaritur sipas formulës $V_n = (Q \times P_n) + (Q \times P_{cn})$, të përcaktuar në aktin e ekspertimit. Në përfundim të arsytimit të vendimit nr. {***} është sqaruar se vlera e fitimit të munguar për periudhën 2005-2011 nuk mund të llogaritet, pasi në çmimin e shitjes së energjisë elektrike ndikojnë dhe faktorë të tjerë që nuk mund të parashikohen në këtë moment, llogaritjet për vlerën e të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike do të bëhet sipas formulës së përcaktuar në aktin e ekspertimit, sipas çmimeve të vërtetuara në treg, $V_n = (Q \times P_n) + (Q \times P_{cn})$, duke dhënë edhe shpjegimin për komponentët e kësaj formule. Në dosjen e subjektit të rivlerësimit, të përcjellë në Kolegj nga Komisioni, nuk gjendet i administruar akti i ekspertimit mbi të cilin është bazuar trupi gjykues, në përbërje të të cilit është edhe subjekti i rivlerësimit, për përcaktimin e dëmshpërblimit, për të kuptuar përse është i pamundur nga ekspertët të përcaktohej dëmi i fitimit të munguar sipas formulës më sipër. Në vendimin e Gjykatës së

³⁰ Neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 parashikon: "Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën".

³¹ Neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 parashikon: "Aspekti i arsytimit ligjor të gjyqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik".

Rrethit Gjyqësor Tiranë është cituar një pjesë nga akti i ekspertimit, sipas së cilit është arritur në përfundimin se: *“Mospërfitimi që llogaritet nga humbja e mundësive të përfitimit nga çmimet e certifikatave jeshile për vitin 2004 është 25.188.5000 euro. Për vitin 2005 e në vijim do të mund të llogaritet në varësi të energjisë elektrike që do të eksportohej dhe çmimit të certifikatave jeshile që do të vërtetohej në treg për secilin vit”*.

16.11. Vlen të theksohet se neni 640 i Kodit Civil parashikon se dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Në këtë rast, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit, pavarësisht se kanë pasur prezent një akt ekspertimi pikërisht për të vlerësuar masën e dëmit të pretenduar nga paditësit, kanë konkluduar në vendim duke vendosur në arsyetim dhe dispozitiv një formulë me shkronja (shih paragrafin më sipër), e cila nëse është e vështirë për t'u përkthyer në shifra nga ekspertët e caktuar nga gjykata për të hartuar aktin e ekspertimit me vlerën e dëmit, duket se do të jetë e palexueshme dhe e pamundur edhe në momentin e ekzekutimit të këtij vendimi. Pra, pavarësisht se gjykata ka konkluduar pranimin e padisë së ngritur nga paditësit, nuk ka përcaktuar vlerën që duhet të përfitojnë këta paditës nga shkaktimi i dëmit. Në këto rrethana, arsyetimi i vendimit duket i paqartë, duke lënë vend për dyshime nëse vendimmarrja ka pasur qëllim ekzekutimin e vendimit në Shqipëri, si dhe duket se nga dhënia e vendimit deri në ekzekutim, dëmi mund të merrte vlera progresive, duke pësuar rritje artificiale, për shkak të mospërcaktimit të tij në vendimet e dy gjykatave shqiptare. Sipas këtij vlerësimi, duket se gjendet i bazuar konkluzioni i Komisionit se arsyetimi i vendimit bie ndesh me dispozitat e Kodit Civil.

16.12. Në vijim të sa më sipër, neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën”*.

Si rrjedhojë e sa më sipër, vlerësohet se aftësia për të interpretuar ligjin është një aspekt i domosdoshëm për vendimmarrjen e gjyqtarit, ku në rastin konkret duket se subjekti i rivlerësimit, me qëndrimin e saj, ka demonstruar problematika në lidhje me zbatueshmërinë e ligjit, si një nga komponentët më të rëndësishëm të aspektit të njohurive ligjore, për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve, duke shkelur kështu kërkesat e nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, konkluzionet e Komisionit për këtë çështje gjenden të bazuara, pasi problematikën e konstatuar në vendimmarrjen e analizuar e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

16.13. Lidhur me problematikën e konstatuar nga Komisioni, për arsyetimin e vendimit nr. {***}, të cituar në paragrafin 16.5 më sipër, ku ka arsyetuar se gjykata duhet të ishte kujdesur që të plotësoheshin kriteret në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe që vendimi të ishte i ekzekutueshëm, pasi subjekti vetë ishte në dijeni të ekzistencës së marrëdhënies së palës paditëse me shoqëritë e huaja, trupi gjykues sjell në vëmendje se KEDNj-ja vendos standardet e domosdoshme dhe garancitë që çdo shtet kontraktues duhet të sigurojë për të realizuar një proces të rregullt ligjor. Në nenin 42 të Kushtetutës dhe në

jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 08.12.2005 (kriteret e arsytimit të vendimit gjyqësor), ka arsyetuar: *“Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshëm për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese [...]”*.

16.14. Gjithashtu, në nenin 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet qartë detyrimi i gjykatave për të arsyetuar çdo vendim gjyqësor që jepet prej tyre. Kodi i Procedurës Civile përcakton rregulla të sakta për formën dhe përmbajtjen e vendimeve gjyqësore. Nenet 306-309 të këtij Kodi bëjnë fjalë për mënyrën e dhënies së vendimit, si dhe formën e tij. Më tej, në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, jepet përmbajtja e vendimit të gjykatës. Sipas kësaj dispozite, ky vendim duhet të përmbajë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. Nga ana tjetër, sipas nenit 126 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi përfundimtar duhet të përmbajë bazën ligjore, mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së saj. Një vendim i ardhur si fryt i një arsytimi të plotë dhe të kuptueshëm ndikon në forcimin e vetë sistemit gjyqësor dhe gjeneron besim ndaj tij në sytë e publikut të gjerë. Për ta lidhur me rastin konkret, vendimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pjesë e trupit gjykues ishte dhe subjekti i rivlerësimit, duket vendim që ka pasur një përlllogaritje të dëmit të pabazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi, si dhe nuk përmban mënyrën e zgjidhjes, pasi në pjesën urdhëruese të tij është vendosur një formulë dhe jo shifër që përbën dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar palës paditëse të cilës i është pranuar padia. Si rrjedhojë e sa më sipër, një vendim relativisht i gjatë, i cili në përmbajtje të tij nuk vjen logjikshëm në pjesën urdhëruese, por citon një formulë të nxjerrë nga ekspertët që kanë hartuar aktin e ekspertimit për përcaktimin e vlerës së dëmit, qartazi ka cenuar procesin e rregullt ligjor në komponentin e tij, atë të arsytimit të vendimeve gjyqësore. Sa më sipër, konkluzioni i Komisionit se është cenuar parimi i procesit të rregullt ligjor gjendet i bazuar.

16.15. Në vijim të sa më sipër, rezultoi se konkluzionet i Komisionit, lidhur me indiciet konfidenciale, qëndrojnë dhe janë të bazuara sa i përket metodologjisë së përlllogaritjes së dëmit, arsytimit të paqartë, mungesës së njohurive ligjore të subjektit të rivlerësimit, zbatimit të gabuar të ligjit dhe shkeljes së nenit 6 të KEDNj-së, të cilat duken se kanë sjellë shqetësim për organet e drejtësisë jashtë vendit, por trupi gjykues në vlerësimin tërësor të tri kriterëve nuk i konsideroi ato si të mjaftueshme për t'i kualifikuar sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për cenim të besimit të publikut të drejtësisë.

17. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 437, datë 10.09.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Kaçe Agolli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 03.07.2024.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi